

Emri i Projektit:	Antea Cement
Shteti:	Shqipëri
Numri i Projektit:	37747
Spektori i Biznesit:	Industri përpunuese
Publik/Privat:	Privat
Kategoria mjedisore:	A
Data e bordit:	25 qershor 2008
Statusi:	Ka marrë miratimin fillestar, Duhet të marrë miratimin final
Data e mbylljes të PSD:	31 mars 2008
Data e perditesimit të PSD:	

Përshkrimi i projektit

dhe objektivat:

BERZH po konsideron një projekt me një financim total prej 29.4 milion Euro në hua dhe investim në kapital për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një fabrike çimentoje të re të projektuar për të prodhuar 1.5 milion ton çimento në vit në një fabrikë që ndodhet afërsisht 30 km në veri të Tiranës. Paketa e financimit do të përfshijë 12.6 milion Euro investim në kapital dhe 16.8 milion Euro në hua të një hierarkie më të ulët (subordinated).

Gjithashtu projekti përfshin zhvillimin e dy guroreve në afërsi të vendndodhjes për të furnizuar fabrikën e çimentos me lëndët e para. Prodhimi planifikohet të fillojë në vitin 2010.

Përveç financimit të BERZH, do të sigurohen fonde nga TITAN SA, një prodhues ndërkombëtar i çimentos dhe gjithashtu edhe nga IFC.

Ndikimi në tranzicion:

Projekti do të jetë një nga investimet industriale të reja më të mëdha në Shqipëri. Potenciali i ndikimit në tranzicion i projektit përfshin dy elementet e mëposhtme:

- **Rritja e konkurrencës / zgjerimi i tregut**

Aktualisht, pjesa më e madhe e kërkesës së Shqipërisë për çimento mbulohet nëpërmjet importit. Prodhuesi i vetëm i çimentos në vend mbulon një pjesë të mirë të kërkesave të Shqipërisë për çimento. Futja e një prodhuesi tjetër të rëndësishëm në tregun lokal të çimentos do të rivendosë presionin e konkurrencës. Një pjesë e prodhimit të kompanisë do të eksportohet në rajon duke përforcuar lidhjet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje.

- **Transferimi i aftësive dhe njohurive**

Futja e Titan në sektorin e çimentos në Shqipëri si një prodhues ndërkombëtar me eksperiencë do të tregojë praktikën më të mirë të industrisë së çimentos kompanive të tjera në Shqipëri si edhe do të sjellë njohuri të reja për punëtorët vendas të cilët do të trajnohen për përdorimin e teknologjive të reja.

- Klienti:** Kompania përfituese është Antea Sh.A, një shoqëri anonime në Shqipëri. Antea Sh.A zotërohet kryesisht nga Titan Cement Company S.A. Titan është një prodhues ndërkombëtar çimentoje me fabrika që punojnë në tre kontinente.
- Financimi i BERZH:** 12.6 milion Euro investim në kapital dhe 16.8 milion Euro hua të një hierarkie më të ulët (subordinated).
- Kosto totale e projektit:** 210 milion Euro.
- Ndikimi ne mjedis:** **Klasifikimi mjedisor dhe arsyetimi**

Projekti është kategorizuar si A/O dhe kërkon një vlerësim të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) në përputhje me Politiken Mjedisore të Bankës (2003) dhe Politiken e Informacionit Publik. Gjithashtu, projekti i nënshtrohet kërkesave shqiptare të VNM. Gjithashtu, projekti është klasifikuar në kategorinë A nga IFC në përputhje me Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë së IFC (2007)

Informacion i rishikuar gjatë vlerësimit mjedisor

Dokumentet e mëposhtëm janë marrë dhe kanë plotësuar *due diligence* mjedisore dhe sociale të projektit në përputhje me Politiken Mjedisore të Bankës:

- Plani për Konsultimin dhe Komunikimin me Publikun (PKKP), Atkins data Tetor 2007, në anglisht dhe në shqip;
- Dokumente të qëllimit të projektit, Atkins, data Tetor 2007, në anglisht dhe në shqip;
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), WS Atkins International Limited, data Shkurt 2008 – në anglisht dhe në shqip;
- Shtojcë, Studim i Planifikimit të Transportit WS Atkins International Limited, data 25 Prill 2007;
- Shtojcë, Studim i Vlerësimit për Sigurinë Rrugore, WS Atkins International Limited, data 12 Dhjetor, 2007;
- Shtojcë, Vlerësim Ekologjik, Prof. Dr. Arsen Proko, data 12 Dhjetor, 2007;
- Sistemi i Planit të Kompensimit Social, WS Atkins International Limited, data Shkurt 2008, në anglisht dhe në shqip;
- Sistemi i Planit të Kompensimit Social, Shtojcat, WS Atkins International Limited, data Shkurt 2008, në anglisht dhe në shqip;
- Llogaritja e emetimit të CO2 në ajër, pa datë
- Përdorimi i gurit gëlqeror, një vizatim që ilustron pamjen përfundimtare të propozuar të gurores së gurit gëlqeror, pa datë
- Përdorimi i flysch, një vizatim që ilustron pamjen përfundimtare të propozuar të gurores së flyschit, pa datë

Përfaqësues të departamenteve mjedisore të BERZH dhe IFC vizituan vendndodhjen, në disa raste gjatë 2007 dhe morën pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin dhe aprovimin final të dokumenteve dhe kriterëve të mësipërme.

Due diligence e kryer dhe përfundimi

Një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social është kryer për Projektin e fabrikës nga një konsulent i pavarur ndërkombëtar. Gjithashtu projekti i është nënshtruar kërkesave shqiptare të VNM. Përfaqësues të Departamenteve Mjedisore të BERZH dhe IFC vizituan vendin si pjese e *due diligence*, vlerësuan dhe miratuan Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Social. Fabrika e re e çimentos do të projektohet në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe do të zbatohen sisteme mjedisore dhe sociale të përshtatshme menaxhimi gjatë fazave të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të Projektit. Gjithashtu Projekti është strukturuar të jetë në përputhje me Udhëzimet BREF të Bashkimit Evropian për Ndotjen dhe Parandalimin ("IPPC") për Prodhimin e Çimentos dhe Gurit Gëlqeror dhe udhëzimet EHS të IFC për Prodhimin e Çimentos. Projekti do të përfshijë masat për zvogëlimin e pluhurit dhe do të sigurojë standardet minimale të shkarkimit të NOx prej 600 mg/Nm³. Meqenëse transporti rrugor do të përdoret edhe për lëndët e para edhe për shpërndarjen e produktit përfundimtar, është zhvilluar një vlerësim i sigurisë rrugore dhe një sistem menaxhimi për të minimizuar ndikimet që lidhen me trafikun.

Antea do të jetë në funksionim fabrikën e re të çimentos dhe guroret që lidhen me të në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare si edhe në përputhje me standardet dhe Udhëzimet EHS të IFC. Një sistem mjedisor menaxhimi dhe një monitorim i vazhdueshëm do të përfshihen në operacionet e përditshme të fabrikës së çimentos.

Publikimi i informacionit dhe konsultimi

Projekti i nënshtrohet një plani për konsultimin dhe komunikimin me publikun.

Materialet e publikuara përfshijnë:

- 2008 Përmbledhja Jo-Teknike e VNMS në shqip dhe në anglisht
- 2008 Deklarata e ndikimit Mjedisor dhe Social, Raporti kryesor dhe Shtojcat në anglisht dhe në shqip.
- 2007 Plani për Konsultimin dhe Komunikimin me Publikun (PKKP) në shqip dhe në anglisht.
- 2008 Skema e Planit të Kompensimit Social në shqip dhe në anglisht.

Materialet janë në gjindshme të printuara në adresat e mëposhtme në Shqipëri

- Zyrat e Antea-s; Rruga e Durrësit (Ish--Uzina Tirana) Pallati "Lim-Em", Seksioni 4D, Kati I, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 423 0402
Tel: 00 355 427 4778
- Zyrat e BERZH në Tiranë; Torre Drin , Kati IV; Rruga "Abdi Toptani" Tiranë, Shqipëri; Tel: +355 42 32898,

Fax: +355 42 30580. Kontakt: Daniel Berg, Drejtor,
email: bergd@ebrd.com

Zyra e IFC, Shqipëri; Dëshmorët e 4 Shkurtit, N. 34, Tiranë,
Shqipëri; Tel: (355-4) 280-650/1; Fax: (355-4) 240-590

Paketa e VNM dhe Përmbledhja Ekzekutive janë nxjerrë për
rishikim publik nga sponsori i projektit në faqen e internetit
www.titan-cement.com dhe janë vënë në dispozicion në
vendndodhjet e mëposhtme:

- Zyrat e Antea-s ; Rruga e Durrësit (Ish--Uzina Tirana)
Pallati "Lim-Em", Seksioni 4D, Kati I
Tirana, Shqipëri
Tel: +355 423 0402
Tel: 00 355 427 4778

Kontakt – Znj. Dobi Teuta. Tel 0 355 6920 90547

- Zyrat e Këshillit Bashkiak të Krujës, Bashkia Kruje;
Kontakt: Znj. SHATRAJ Dashurie. Tel 00 355 6922
19607
- Zyrat e komunës Thumanë; Fshati Thumanë. Kontakt:
Z. MIHA Konstantin. Tel. 00 355 6940 60129

Për më tepër Përmbledhja Ekzekutive është në
dispozicion në faqen e internetit të BERZH në
www.ebrd.com, një kopje e plotë e VNM është në
dispozicion nga Banka Botërore InfoShop:

World Bank InfoShop
1818 H Street, N.W., Room J1-060
Washington, DC 20433
USA
Telefon: (202)-458-4500 (USA, 9:30am – 3:30pm EST)
Fax: (202) 522-1500 (USA)
E-mail: pic@worldbank.org

Monitorimi dhe raportimi

Kompania do të monitoroje ndikimin mjedisor të veprimeve të saj në përputhje me ligjin dhe rregullat kombëtare. Banka do të vlerësojë përputhjen e projektit me kërkesat e aplikuara mjedisore dhe sociale gjatë gjithë zhvillimit të projektit duke rishikuar raportet mjedisore vjetore që përfshijnë:

(i) ecurinë e vazhdueshme të aktiviteteve specifike mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë të lidhura me projektin ashtu siç reflektohen në rezultatet e vrojtimit periodike dhe sasiore dhe në programet e matjeve, dhe

(ii) gjendjen e zbatimit të masave zbutëse mjedisore dhe masat përmirësuese. Përfaqësuesit e Bankës do të kryejnë gjithashtu vizita periodike kontrolluese kur në periudhat kur konsiderohet e përshtatshme.

Banka do të kryejë monitorimin e Projektit, duke përfshirë vizitat në vendndodhje nga stafi i Bankës si edhe auditimet e pavarura dhe një audit kur të ketë filluar shfrytëzimi pasi të jetë ndërtuar fabrika.

Për këtë projekt ka një [Vlerësim të Ndikimit Mjedisor](#) në dispozicion.

Bashkëpunimi teknik: Asnjë.

Për mundësi konsultimi për projekte të financuara nga fonde teknike bashkëpunimi vizitoni [prokurim i konsulentëve](#)

Kontakte të kompanisë: Z. Lefteris Garis
Drejtor për Shqipërinë,
Rruga e Durrësit (Ish--Uzina Tirana)
Pallati "Lim-Em", Seksioni 4D, Kati I
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 423 0402
Tel: 00 355 427 4778

Për pyetje në lidhje me projektin ju lutem kontaktoni:

Çështje sociale: Kontakt – Znj. Dobi Teuta. Tel 0 355 6920 90547

Pyetje të përgjithshme mbi Projektin. Kontakt: Z. Bylyku Adrian.
Tel.: 00 355 6920 93726

Kontakte të BERZH: Holger Muent, Drejtues i projektit: muenth@ebrd.com

Mundësi për biznes: Për mundësi biznesi ose prokurimi, kontaktoni kompaninë e klientit.

Kërkesa të përgjithshme: Pyetje për projekte të BERZH që nuk lidhen me prokurimin:
Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380
Email: projectenquiries@ebrd.com